

VENDIM
Nr. 104, datë 23.6.2016

MBI PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË VLERAVE REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITSHME, SI DHE MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE-s NR. 49, DATË 21.10.2004 DHE NR. 146, DATË 24.12.2013

Në mbështetje të neneve 16, 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me miratimin e “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese” në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padis-ponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”,

konstatoi:

- Me shkresën e OSHEE sh.a. nr. 10473 prot., datë 2.6.2016, është bërë me dije se deri në datën 30 qershor, OSHEE sh.a. do të realizojë pajisjen me matës të të gjithë klientëve.

- Në nenin 76 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” është parashikuar: “Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

- Me shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matës jashtë kushtit teknik” dhe nr. 146, datë 24.12.2013, “Mbi kërkesën e “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe përmbushen parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matës jashtë kushtit teknik” dhe nr. 146, datë 24.12.2013, “Mbi kërkesën e “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe” dhe të çdo vendimi që bie në kundërshtim me këtë vendim.

2. Në rastet kur furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar apo jashtë kushtit teknik) e bën faturimin duke u bazuar në mesataren mujore të faturimit me matje të 3 muajve respektivë të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti